



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT  
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E METROLOGJISË  
DREJTORIA E METROLOGJISË LIGJORE

Nr. 612/1 prot.

Tiranë, më 30.03.2024

Lënda: Kthim përgjigje.

Në vijim të kërkesës Suaj, protokolluar në Drejtorinë e Përgjithshme të Metrologjisë (DPM) me Nr. 612, datë 13.03.2024, Ju bëjmë me dije si më poshtë :

Në mbështetje dhe zbatim të ligjit nr. 126, datë 15.10.2020 "Për Metrologjinë", Drejtoria e Përgjithshme të Metrologjisë (DPM) nuk ka detyrë dhe kompetencë verifikimin e instrumentave matës ligjërisht të kontrolluara, shpërndarës karburanti (distributor), si dhe nuk ka asnjë të drejtë ligjore mbi këto instrumente, për rrjedhojë nuk ka kompetencë për trajtimin e ankesës Tuaj.

Shërbimi i verifikimit të instrumentave matës ligjërisht të kontrolluara, shpërndarës karburanti (distributor), kryhet nga kompania koncesionare dhe ankesat për këtë tip instrumenti matës trajtohen nga Inspektoriati Shtetëror i Mbikëqyrjes së Tregut (ISHMT).

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

**DREJTOR I PËRGJITHSHËM**

**Petrit Rama**

